



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VIII.**  
**Sesioni vjeshtor**

**PËR: Komisionin për Buxhet , Punë dhe Transfere**  
**Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe**  
**Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit**  
**Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**  
**Komisionin për Integritim Evropian**

**NGA: Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

**Lënda: Raport për Projektligjin nr.08/L-255 për shërbime sociale dhe familjare**

**Nr. 08/L-255**

**Datë: 5 dhjetor 2023**

---

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 76 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në disa mbledhje të mbajtura, shqyrtoi Projektligjin nr.08/L-255 për shërbime sociale dhe familjare, ndërsa në mbledhjen e mbajtur me 5 dhjetor 2023, vendosi që të paraqet këtë:

**R A P O R T**

**Për Projektligjin nr.08/L-255 për shërbime sociale dhe familjare**

**Amendamenti 1**

Neni 1 riformulohet si vijon :

Ky ligj rregullon shërbimet sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve publike që hartojnë politika dhe ofrojnë shërbime sociale dhe familjare si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare

**Amendamenti 2**

Në nenin 2, pas fjalës „zbatohen”, lidhëza „, për “ zëvendësohet me lidhëzën„ nga” .

**Amendamenti 3**

Në nenin 3, paragrafi 1.1. fshihet fjala „, zvogëlimin “.

#### **Amendamenti 4**

Në nenin 3, paragrafi 1.8 riformulohet si vijon :

**1.8. Ministria** – Ministria përkatëse për çështje sociale.

#### **Amendamenti 5**

Në nenin 3, paragrafi 1.27, riformulohet si vijon:

**1.27. Bashkësia jashtëmartesore** - bashkësia jetësore e gruas dhe burrit të cilët nuk kanë një martës të ligjshme bashkë, e që i plotëson kushtet e parapara me ligjin e veçantë me të cilin rregullohen marrëdhëniet familjare;

#### **Amendamenti 6**

Në neni 5, paragrafin 1.3, fjala „Rikthimi“ të zëvendësohet me fjalën „vendosjen” .

#### **Amendamenti 7**

Në neni 5, paragrafin 3, në fund të paragrafit pas fjalës „sipas” shtohet fjala „, këtij”.

#### **Amendamenti 8**

Në nenin 7, paragrafi 2 , pas fjalëve „mbrojtjes sociale” shtohet lidhëza „, si “.

#### **Amendamenti 9**

Në nenin 12, paragrafi 2, riformulohet si vijon:

2. Komunat marrin pjesë në financim të shërbimeve sociale dhe familjare në bashkëpunim dhe bashkërendim ndërkomunal.

#### **Amendamenti 10**

Në nenin 21, paragrafi 4, pas fjalës „, kontest për “ shtohet fjala „, punë”.

#### **Amendamenti 11**

Në nenin 21, paragrafi 5, në fund të paragrafit fshihen fjalët „, i Drejtësisë (në tekstin e mëtejshëm: Ministri).

#### **Amendamenti 12**

Në nenin 22, pas paragrafit 8, shtohen dy paragrafë të ri, dhe bëhet rirenditja e paragrafëve :

9. Paneli për strehim familjar funksionon në kuadër të Departamenti përkatës në Ministri, i cili emërohet nga Ministri prej pesë (5) anëtarëve, me përbërje tre (3) përfaqësues nga Departamenti përkatës në Ministri, një (1) përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale dhe një (1) përfaqësues nga organizatat joqeveritare.

10. Organizimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Panelit për strehim familjar përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.

#### **Amendamenti 13**

Në nenin 24, pas paragrafit 3, shtohen tre paragraf të ri , dhe bëhet rirenditja e paragrafëve:

4. Paneli për strehim rezidencial funksionon në kuadër të Departamenti përkatës në Ministri, i cili emërohet nga Ministri prej tre (3) anëtarëve, me përbërje dy (2) përfaqësues nga Departamenti përkatës në Ministri, një (1) përfaqësues nga institucionet e përkujdesit rezidencial.

5. Paneli për strehim rezidencial në nivel lokal funksionon në kuadër të Komunës, i cili emërohet nga Komuna prej tre (3) anëtarëve, me përbërje një (1) përfaqësues nga Drejtorati komunal përkatës, një (1) përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale dhe një (1) përfaqësues nga institucioni i përkujdesit rezidencial.

6. Organizimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Panelit për strehim rezidencial përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.

#### **Amendamenti 14**

Në nenin 27, pas paragrafit 6, shtohen dy paragrafë të ri, dhe bëhet rirenditja e paragrafëve :

7. Paneli për adoptim funksionon në kuadër të Departamenti përkatës në Ministri, i cili emërohet nga Ministri prej pesë (5) anëtarëve, me përbërje tre (3) përfaqësues nga Departamenti përkatës në Ministri, një (1) përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale dhe një (1) përfaqësues nga organizatat joqeveritare.

8. Organizimi detyrat dhe përgjegjësitë e Panelit për adoptim përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri

#### **Amendamenti 15**

Në nenin 28, paragrafi 11, në fund të paragrafit fjalia „komisioni përkatës profesional” zëvendësohet me fjalinë „organi i kujdestarisë”.

#### **Amendamenti 16**

Në nenin 28, pas paragrafit 12, shtohet paragraf i ri dhe bëhet rirenditja e paragrafëve :

13. Procedura për përcaktimin e fakteve dhe ekzistencën e bazës për realizimin e të drejtave për aftësim për jetesë dhe punë të pavarur duhet të fillojë më së largu me arritjen e moshës 16 vjeçare , dhe kryhet profesionalisht nga organi i kujdestari në bashkëpunim me kujdestarin ligjor, familjen strehuese apo institucionin rezidencial.

#### **Amendamenti 17**

Në nenin 28, paragrafi 13, fjala „kompetent” zëvendësohet me fjalën „i kujdestarisë”.

#### **Amendamenti 18**

Në nenin 31, pjesa e parë e paragrafit 1. riformulohet:

1. Përfitues i shërbimeve sociale është personi madhor dhe personi i moshuar :

#### **Amendamenti 19**

Në neni 32, paragrafi 1, fjala „Zhvillon” zëvendësohet me fjalën „Harton “.

#### **Amendamenti 20**

Në neni 32, paragrafi 2, fshihet fjala „ të këshillimit“.

### **Amendamenti 21**

Në neni 32, paragrafi 3, riformulohet si vijon :

3. Licencon personat fizik dhe juridik, ofrues të shërbimeve sociale dhe është përgjegjëse për themelimin e institucioneve të kujdesit sociale e rezidencial për ofrimine e shërbimeve sociale dhe familjare.

### **Amendamenti 22**

Në neni 36, paragrafi 3, në fund të paragrafit fshihen fjalët,, si në vijim:”.

### **Amendamenti 23**

Në nenin 36, në fund të paragrafit 4, shtohet fjalia: qendrat për punë sociale një(1) anëtarë dhe një (1) zëvendës anëtar.

### **Amendamenti 24**

Në nenin 37, para paragrafit 2, riformulohet si vijon:

2. Kundër vendimit të Qendrës për Punë Sociale, pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë në Komisionin përkatës për ankesa, i cili përbëhet nga tre (3) anëtar, përfaqësues të departamenti përkatës për mirëqenie sociale në Ministri.

### **Amendamenti 25**

Në nenin 38, paragrafin 9, pas fjalës „pa vonesë” shtohet fjalia,, jo më larg se shtatë (7) ditë, “.

### **Amendamenti 26**

Në nenin 38, paragrafin 10, pas fjalës „pa vonesë” shtohet fjalia,, jo më larg se shtatë (7) ditë, “.

### **Amendamenti 27**

Në nenin 38, paragrafi 14, në fund të paragrafit fshihet fjala „ gjetur” dhe shtohet fjalia,, paraqitur kërkesa apo është gjetur personi”.

### **Amendamenti 28**

Në nenin 39, paragrafi 4, para fjalës „Përjashtimin” shtohet „ Për”.

### **Amendamenti 29**

Në nenin 40, paragrafi 1, pas fjalës „ përcaktuara” shtohet fjalia,, sipas këtij ligji”.

### **Amendamenti 30**

Në neni 42, paragrafi 3, riformulohet si vijon :

3. Qendra për Punë Sociale për përfituesin e të drejtës së shërbimit social konstaton nevojën në bazë të vlerësimit të kryer pas vizitës së drejtpërdrejtë në shtëpinë apo banesën e përfituesit, në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

### **Amendamenti 31**

Në neni 43, paragrafi 3, lidhësa „ndërsa” zëvendësohet me fjalinë „ dhe në këtë rast” .

### **Amendamenti 32**

Në neni 43, paragrafi 5, fshihet fjala „urdhëron “ dhe zëvendësohet me fjalinë „ ndërmerr veprime për”.

### **Amendamenti 33**

Në neni 43, paragrafi 6, riformulohet si vijon:

6. Në rastin nga paragrafi 5 i këtij neni, vendimi për ofrimin e shërbimit të menjëhershëm nxirret në formën e shkruar në afat prej tetë (8) ditësh .

### **Amendamenti 34**

Në neni 44, paragrafi 1, fshihen fjalët „ushqyesi/mbajtësi “ dhe zëvendësohen me fjalinë „ personi përgjegjës sipas ligjit”.

### **Amendamenti 35**

Në neni 51, paragrafi 2, fjala „, Regjistri i” zëvendësohet me „, Llojet e” .

### **Amendamenti 36**

Në neni 52, paragrafi 4, fshihet fjala „,ekspertësh” dhe zëvendësohet me fjalën „, i profesionistëve “.

### **Amendamenti 37**

Në neni 52, paragrafi 5, fjala „, udhëheqësi” zëvendësohet me fjalën „,drejtori”.

### **Amendamenti 38**

Në neni 52, paragrafi 7, riformulohet si vijon :

7. Organizimi, përgjegjësitë, lloji dhe numri i profesionistëve si dhe funksionimi i Qendrës për Punë Sociale rregullohet me akt nënligjor të propozuar nga Ministria dhe të miratuar nga Qeveria.

### **Amendamenti 39**

Në neni 53, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. fshihet fjalia „, të mbrojtjes së fëmijës, të mbrojtjes familjare juridike dhe të përkujdesit, të mbrojtjes juridike të të miturit dhe të drejtave tjera në pajtim me ligjin”.

### **Amendamenti 40**

Në neni 54, paragrafi 2, riformulohet si vijon:

2. Në territorin e komunës mund të ketë një apo më shumë këshillimore familjare.

### **Amendamenti 41**

Në neni 62, paragrafi 4, riformulohet si vijon :

4. Qëndrimi në qendrën pranuese mund të zgjasë deri në pesëmbëdhjete (15) ditë, ndërsa vetëm në situatat e veçanta mund të zgjasë deri në tridhjetë (30) ditë, nëse procedura e gjetjes së formës adekuate të përkujdesjes e kërkon këtë.

### **Amendamenti 42**

Në neni 68, riformulohet si vijon:

**Neni 68**  
**Licencimi**

1. Institucione publike, si dhe organizatat joqeveritare dhe personat fizik e juridike për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare licencohen nga Ministria.

2. Licenca nga paragrafi 1, i këtij neni i lëshohet ofruesit të shërbimeve sociale dhe familjare në kohëzgjatje prej tri (3) vite me mundësi të rilicencimit çdo pesë (5) vite.

#### **Amendamenti 43**

Në neni 69, paragrafi 2, fjala „ Licenca “ zëvendësohet me fjalën „ Rilicencimi”

#### **Amendamenti 44**

Në neni 72, paragrafin 2, nënparagrafi 2.5. riformulohet si vijon:

2.5. Mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve dhe masave të shqiptuara.

#### **Amendamenti 45**

Në neni 72, paragrafin 2, pas nënparagrafi 2.6. shtohet paragraf i ri si vijon:

2.7. rekomandon marrjen e licencës për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në rastet kur personi fizik, personi juridik apo organizata joqeveritare dështon në ofrimin e shërbimeve dhe zbatimin e standardeve minimale.

#### **Amendamenti 46**

Në neni 73, paragrafin 2, nënparagrafin 2.1. riformulohet si vijon :

2.1. marrjen e përgjegjësive të drejtpërdrejta të shërbimeve sociale dhe familjare në rastet kur komuna dështon në ofrimin e shërbimeve.

#### **Amendamenti 47**

Në neni 73, pas paragrafit 2, shtohet paragraf i ri si vijon:

3. Në rast të ndalimit të punës për ofruesit e shërbimeve sociale jopublike dhe për ofruesit individual të shërbimeve sociale dhe familjare nga paragrafi 2 i këtij neni, Ministria e obligon Komunën dhe Qendrën për Punë Sociale përkatëse për gjetjen e mbrojtjes alternative për përfituesit e shërbimeve.

#### **Amendamenti 48**

Në neni 74, paragrafin 5, fjala „, garantin” zëvendësohet me fjalën „, grantin”

#### **Amendamenti 49**

Në neni 79, paragrafin 3, riformulohet si vijon :

3. Përmbajtja e licencës rregullohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.

#### **Amendamenti 50**

Në neni 81, paragrafin 2, numri brenda kllapave „ (30) zëvendësohet me „ (300)”.’

### **Amendamenti 51**

Në neni 81, paragrafin 3, riformulohet si vijon:

3. Personi fizik që ofron shërbime përkatëse, dënohet me gjobë prej dyqind (200) euro, deri në pesmijë(5.000) në rastet kur është përgjegjës sipas paragrafit 1 të këtij neni.

### **Amendamenti 52**

Në neni 82, paragrafin 1, fshihet fjala,, muajve”.

### **Amendamenti 53**

Në neni 85, fjalët ,, pushon të vlejë” zëvendësohet me fjalën ,, shfuqizohet”.

I. Ky raport u përpilua nga Komisioni funksional dhe do t’u dërgohet komisioneve kryesore për ta shqyrtuar Projektligjin, andaj ky raport do të jetë përfundimtar lidhur me këtë Projektligj, pasi të jepen edhe rekomandimet eventuale nga komisionet kryesore.

II. Për këtë Projektligj, Komisioni nuk ka pranuar ndonjë amendament.

III. Arsyetimin lidhur me këtë rekomandime, do ta paraqesë deputetja Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit.

Kryetare e Komisionit  
**Fatmire Kollçaku**

---